



UNIVERSITETI
I SHKENCAVE TË APLIKUARA
— FERIZAJ —

UNIVERSITETI I SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ
UNIVERSITY OF APPLIED SCIENCES IN FERIZAJ

Njësia Org.

Org. Unit

Nr. i faqeve

No. pages

Nr. Prot:

Prot. No:

Data:

Date:

261/24

06.02.24

Njoftim për zgjedhjet studentore 2024

Bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), si dhe Rregullores për Zgjedhjet Studentore, Këshilli Drejtues (KD) i UShAF, në mbledhjen e mbajtur me datën 19.01.2024, ka marrë vendim për shpalljen e zgjedhjeve studentore për anëtarë të Parlamentit Studentor, të cilat do të mbahen me datën 22.02.2024.

Universiteti i Shkencave të Aplikuara në Ferizaj inkurajon të gjithë studentët e Universitetit që të marrin pjesë në zgjedhje dhe të votojnë organizatën, respektivisht kandidatët e nominuar në organizatën përkatëse, që ata mendojnë, se më së miri do t'i përfaqësojnë interesat e tyre përmes Parlamentit Studentor në Këshillin Mësimor/Shkencor dhe Senat të Universitetit.

Universiteti inkurajon kandidimin e studentëve më të mirë dhe të gjitha Organizatat Studentore, të cilat në programet e tyre nuk kanë agjendë politike, fetare dhe racore, që denjësisht t'i përfaqësojnë dhe mbrojnë interesat e studentëve.

Organizatrat studentore, të interesuara për të marr pjesë në Zgjedhjet Studentore për anëtar të Parlamentit Studentor të UShAF, do të certifikohen nga Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) me datën 12.02.2024. Paraprakisht Organizatat Studentore duhet të jenë të regjistruara në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe e Administratës Publike, konform Ligjit për Lirinë e Asociimit në organizatat joqeveritare. Me rastin e aplikimit për certifikim në KQZ, Organizatat Studentore duhet të dorëzojnë edhe listën e deklaratimit të studentëve në mbështetje për certifikimin e Organizatës Studentore për Zgjedhjet Studentore 2024, me më së paku 100 nënshkrime për certifikim për Zgjedhjet e Parlamentit Studentor.

Po ashtu, anëtarët e nominuar në listat e Organizatave Studentore për anëtarë të Parlamentit Studentor, duhet të jenë të nënshkruara dhe çdo kandidat i nominuar në listë duhet të ofrojë deklaratë se pranon kandidaturën.

Për informata më të hollësishme lidhur me mbarëvajtjen e procesit zgjedhor, kontaktoni në email adresën info@ushaf.net

Kryesuesi i KQZ
Armend Hysa